

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2026,
4. Të ndryshme.

Ky rend i ditës u miratua me 9 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Pika e Parë të Rendit të Ditës **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Koordinatori, z. Besart Tofaj, tha se materialet i keni pranuar me kohë dhe se, nëse keni vërejtje apo komente rreth procesverbalit, mund t'i bëni.

Kjo pikë e rendit të ditës u miratua me 9 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës **Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut**

Komandanti i Policisë në Junik, z. Rasim Sylja, tha se gjendja e sigurisë, si zakonisht, në Komunën e Junikut është e qetë dhe se, nga takimi i fundit i KKBS-së, më 14 maj, kemi pasur vetëm dy raste penale, ku kemi konfiskuar tri armë zjarri ilegale. Kemi pasur një aksident, i cili është administruar nga Trafiku Rajonal në Pejë. Tutje tha se Policia i ka disa projekte për sigurinë e përgjithshme, duke përfshirë parandalimin e veprave penale dhe arrestimin e personave përgjegjës, si dhe rregullimin e trafikut, ku në këto projekte qaset thuhet secili sektor. Tek veprat penale hyjnë: grabitjet, vjedhjet, vrasjet dhe të tjera, ndërsa kur flasim për rregullimin e trafikut kemi parasysh parandalimin e aksidenteve, lirim të trotuareve, gjërat ndaj kundërvajtësve dhe të tjera.

E vlerësojmë si situatë të kënaqshme të sigurisë. Tash, në sezonin e verës, kemi edhe projekte të tjera kur fillon ardhja e bashkatdhetarëve dhe besoj se, me koordinimin e të gjitha institucioneve, situata e sigurisë do të vazhdojë të jetë, ashtu si vitet e mëhershme pra situatë e qetë. Si dhe theksoj që për një muaj i kemi shqiptuar rreth 60 gjopa në trafik.

Nënkryetari pyeti nëse sekuestrimi i armëve ka ndodhur në zonën e Bjeshkëve apo në zonën e qytetit të Junikut.

Komandanti u përgjigj se këto armë janë sekuestruar në zonën e qytetit të Junikut.

Nënkryetari tha se, jo zyrtarisht, ka informata që në zonën e Bjeshkëve ka armë pa leje në bujtina (stane).

Komandanti tha se mund të ketë, por që, për ta bastisur dikë, duhet të kemi një urdhër nga Prokuroria dhe duhet të kemi prova të mjaftueshme që të na lejohet bastisja e ndonjë bujtine. Policia e Kosovës, sapo të ketë informata për diçka të tillë, do të koordinohet dhe do të reagojë sa më shpejt.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2026

Nënkryetari, z. Besart Tofaj, elaboroi Planin e Punës për këtë vit, i hartuar së bashku me Komisionin për hartimin e këtij plani. U theksua se kishte pasur kërkesa që disa pika të hiqeshin, si p.sh. pika për rezultatet e arritshmërisë së maturantëve në shkolla, pasi u vlerësua se kjo çështje nuk lidhet drejtpërdrejt me mandatin e KKS-së.

Z. Xhavit Velijaj dha sugjerime lidhur me bartësit e disa pikave të planit, të cilat u pranuan të implementoheshin.

Plani, me ndryshimet e propozuara, u hodh në votim dhe u miratua me 9 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Pika e Katër e Rendit të Ditës Të ndryshme

Z. Driton Sylja tha se i ka paraqitur një kërkesë me shkrim Kryetarit lidhur me policët e shtrirë te Teqja, mirëpo ka kaluar një kohë e gjatë pa pasur ndonjë reagim. Ai shtoi se ai segment ka mbetur pa sinjalizimin përkatës dhe kërkoi që kjo çështje të trajtohet me seriozitet. Gjithashtu, theksoi se është diskutuar edhe për zëvendësimin e një table, por ende nuk ka pasur ndonjë veprim konkret.

Nënkryetari, z. Besart Tofaj, tha se do të verifikojë se deri në cilën fazë ka arritur kjo procedurë, pasi segmenti rrugor të cilit i referohet është rrugë rajonale.

Me kaq, nënkryetari Besart Tofaj e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi,

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKS-së

Esat Hoxha

Ruzhdi Shehu